
FOR A NEW BREATH LITERATURE TEACHING

Alma Hafizi

University of Shkodër, Albania, ahafizi@unishk.edu.al

Abstract: Until the beginning of the last century, Literature teaching of literature was based on the literature - national identity-history triangle, which has been realized thanks to the mediator role of the literary teacher. In the decades that followed, this connection has been weakening until the structure upon which education and literary education were based, was no longer functional. The notion of community of relevance has changed, and much more in the new conditions of globalization it is far wider than the national notion, so that it becomes imperceptible, almost invisible. The situation in which the Literature teacher is, therefore, has changed. We are facing with a faster circulation of ideas, a mixture of cultures, peoples and ethnicities, with a digitalized society that puts into crisis the written texts authority, as well as with the selection of texts which are not based on the priority role of the linguistic element, consequently not a predominantly national literature, with students who are overwhelmed with information about everything. Thus, a need for change arises in Literature teaching, from a national literary education and training to a widely cultural literary education. In this modest contribution we will try to think about what needs to be changed, how to be changed, by bringing models of literary didactic units. At present, Literature is a reality, quite different from the traditional concept about it. Hence, Literature also requires current methods for the young generations education with its values.

Keywords: Literature, changes, didactic, national, globalization.

PËR NJË FRYMARRJE TË RE NË MËSIMDHËNIEN E LETËRSISË.

Alma Hafizi

University of Shkodër, Albania, ahafizi@unishk.edu.al

Deri në fillimet e shekullit të kaluar mësimdhënia e letërsisë bazohej në trekëndëshin letërsi-identitet kombëtar-histori, i realizuar falë rolit mediator të mësuesit të letërsisë. Në dhjetëvjeçarët që pasuan kjo lidhje erdhi duke u dobësuar derisa struktura mbi të cilën mbështetej edukimi dhe formimi letrar doli jashtë funksionit. Nocioni i komunitetit të përkatësisë ka ndryshuar, aq më tepër në kushtet e reja të globalizmit, është shumë më i gjerë se nocioni kombëtar, aq sa bëhet i papercptueshëm, thuajse i padukshëm. Situata ku ndodhet mësuesi i letërsisë, për rrjedhojë, ka ndryshuar. Kemi të bëjmë me qarkullim më të shpejtë idesh, me përzjerje kulturash, popujsh dhe etnish, me një shoqëri të dixhitalizuar që vë në krizë autoritetin e tekstit të shkruar, me përzgjedhje tekstesh që nuk bazohen në rolin prioritar të elementit gjuhësor, pra jo kryesisht letërsi kombëtare, me nxënës, studentë, të tejngopur me informacion në kohë reale mbi gjithçka. Pra, lind ngushtësisht nevoja për ndryshimin e mësimdhënies së letërsisë, nga formim dhe edukim letrar kombëtar në formimin letrar gjerësisht kulturor. Në këtë kontribut modest do të provojmë të reflektojmë mbi atë se çfarë duhet ndryshuar, si duhet ndryshuar, duke sjellë edhe modele njësisht didaktike letrare. Letërsia sot është një realitet tjetër nga koncepti tradicional për të, prandaj edhe kërkon metoda aktuale për edukimin e brezave të rinj me vlerat e saj.

Fjalë kyçe: Letërsi, ndryshim, didaktikë, kombëtare, globalizëm.

Letërsia si disiplinë kurrikulare perceptohet në mënyra të ndryshme nga aktorë të ndryshëm, nga nxënësit dhe nga mësimdhënësit. Për grupin e parë konsiderohet jo rallë herë si shumë tekstesh të shkruara, që mbartin vlerë artistike dhe etike dhe që lexohen, në rastin më të mirë. Për mësuesit, ndryshe nga të parët, është një disiplinë që paraqet problematika dhe vështirësi didaktike. Deri në fillimshkullin e kaluar, mësimi i letërsisë mbështetej në trekëndëshin letërsi, identitet kombëtar, histori, në mes të të cilit qendronte mësuesi, një raport që atëkohë e në vazhdim ka ardhur duke u zbehur derisa arriti shpërbërjen përfundimtare nga fundi i po atij shekulli. Ky fenomen u shoqërua edhe me pasoja në fushën e mësimdhënies (Boerdieu 2005).ⁱ Kishte perënduar funksioni intelektual i mësuesit të letërsisë që i përcaktonte ai lloj ndërmjetësimi, që në momentin që ishte mposhtur nga shumë dilema që kërkonin zgjidhje; çfarë roli ndërmjetësimi do të kishte mësuesi i letërsisë në vazhdim? Çfarë kuptimi konotativ do të kishte fjala *ne*, për të cilën aq shumë hulumtojmë nëpër vepra letrare?

Ne është korniza brenda së cilës perceptojmë ekzistencën tonë, dhe shfaqet në ndryshim të vazhdueshëm. Le të i refrohemi dy shembujve që sjell kritiku italian Romano Luperini, atë të Francesco de Sanctis-it dhe të Auerbach, për të parë më qartë sesi *ne* është pre e përhershme e transformimeve. *Historia e letërsisë italiane* e De Sanctis-it (1912)ⁱⁱ i përket periudhës së procesit të bashkimit kombëtar të Italisë dhe i referohet në përgjithësi një

bashkësie kombëtare në formim e sipër. *Ne i De Sanctis*-it ishte perceptimi romantik rizorxhimental i një populli të veçantë që po shndërrohej në një komb. Interpretimi i lëvizjes rizorxhimentale si kundërvënie e kulturës klasike të traditës dhe i tendencave politike reaksionare në Itali, që e mbanin larg kulturës evropiane, i dha veprës famën e një kryevepre në mbarë kontinentin. Në veprën e *De Sanctis*-it elementi i veçantë me atë universal gërshetohen ngjeshur. Auerbach, i arratisur gjatë luftës në Stamboll për t'i shpëtuar nazizmit, përshkruan linjat e letërsisë perëndimore në veprën *Mimesis*, duke qendruar jashtë kësaj kulture, duke e analizuar nga një këndvështrim që “vihet në lëvizje nga kultura dhe gjuha kombëtare, por i aftë të shkëputet prej tyre, madje edhe t'i kapërcejë” (Auerbach 1970)ⁱⁱⁱ. Për shkrimtarin e madh hebraik, një shekull pas *De Sanctis*-it, e veçanta dhe universalja konceptohen ndryshe, janë shkruar në një.

Situata e sotme është pothuajse e ngjashme me atë në të cilën ndodhej Auerbach gjatë luftës së dytë botërore, po t'i shtohet këtij kuadri edhe informacioni i tepruar që qarkullon sot në botë, prania gjithnjë e më e madhe e një internacionalizmi kulturor, qarkullimi i ideve dhe përzierja e popujve, etnive, racave gjithnjë më në rritje. Në epokën e globalizmit *ne* shfaq tendenca zgjerimi, por edhe një lloj prezantimi që e bën përherë e më të padukshme, më të papërceptueshme. Mësuesi i letërsisë duhet të përballet pra, nga njëra anë, me ndryshimin e përmasave fizike të identitetit, me një nxënës me imagjinatë të gjithanshme, shumë i informuar në kohë reale mbi gjithçka ndodh në planetin tonë, me një shoqëri të dixhitalizuar që zhvillon me një shpejtësi të frikshme proceset mendore e kulturore, që rend me ngut drejt së ardhmes duke i shkëputur fijet lidhëse me të kaluarën, që do të thotë se refuzon kujtesën historike. Nga ana tjetër, mësuesi ndjen presionin e mësimdhënies së letërsisë, kryesisht kombëtare.

I ndodhur në kushte të tilla, mësuesi i letërsisë duhet të sforcohet që të ndryshojë metodën e mësimdhënies dhe konceptimin e saj, rolin që tashmë merr teksti letrar, të përcaktojë qartë motivimin dhe qëllimin e produktit të tij. Të mbajmë parasysh këtu se mësuesi i letërsisë në shkollat e ciklit të lartë të arsimit të mesëm gjendet nën presion të dykrahshëm që rrezikon t'i shkatërrojë personalitetin si edukator; nga njëra anë mësimdhënien e letërsisë, kryesisht asaj kombëtare, pa asnjë arsytim apo rrëfim mitik që ta justifikojë, nga ana tjetër, qendrojnë fëmijë me një imagjinatë gjithëpërfshirëse, të rritur me filmat e animuar japonezë, me muzikë e këngë amerikane, me filma që i serviren çdo shikuesi në tregun botëror, nëse lexojnë, *bestseller* e autorë nga e gjithë bota, veprat e të cilëve përkthehen në të gjitha gjuhët e palnetit (Fortini 1977)^{iv}. Në këtë situatë të kërkosh një lexim historiografik të letërsisë kombëtare, në të vërtetë e shndërruar në një kronologji të plogësht e pa pathos, apo të jesh didakt dhe të ushtrosh mësimdhënien si praktikë tërësisht tekniko-formale, gjuhësore apo retorike, është një zgjidhje pak shpresëdhënëse, për të cilën shkolla prej kohësh ka dhënë shënja. Natyrisht që nuk mund të anashkalohet kushtëzimi që krijon elementi gjuhësor, duke privilegjuar letërsinë kombëtare, por as fakti se, me kohën dhe proceset globalizuese në veprim, ai element shfaqet më pak themelor sesa dikur.

A është e mundur të ndërtohet një identitet i ri për mësuesit e letërsisë? A mund të tregohet letërsia në një mënyrë tjetër nga ajo që na është transmetuar që prej dy shekujsh? T'i japësh një përgjigje pozitive këtyre fakteve nuk është e lehtë, edhe sepse përfshijnë çështje që nuk lidhen vetëm me mësimdhënien e letërsisë, por me qenien e mësuesit si intelektual, figura e të cilit ka ndryshuar rrënjësisht në dekadat e fundit. Nga shkrimtari i shquar francez Emil Zola me *Çështjen Dreyfus*,^v tek Russel e Sartre, deri tek një çështje tjetër, *Çështja Moro* e Leonardo Sciascia^{vi}, intelektualët kanë luajtur rolin e ndërmjetësuesve që i kanë dhënë tonin një komuniteti, shoqërie. Ata karakterizoheshin nga një autoritet i dallueshëm, siç ka shkruar Bourdieu, “me përkatësinë ndaj një bote relativisht autonome artistike, letrare, shkencore, me të gjitha vlerat që e dallon këtë lloj autonomie”. Ishte “misioni i të diturve”, siç e quante Fichte që në fillimet e shekullit XIX. Kjo traditë ka vazhduar deri nga vitet 1970. Shkrimtari i shquar italian Fortini, ndërsa përshkruan dhe shpjegon raportin në të cilin vendosen elementet e trekëndëshit intelektual-rol-funksion, shkruante se “procesi i shkatërrimit të trupit nga intelektualit ka përparuar aq sa vetë termi intelektual thuhet nuk përdoret” (Fortini 1977).

Këtyre proceseve u nënshtrohet edhe trupa e mësimdhënësve, duke dhënë alarmin për zëvendësimin e funksioneve tradicionale të mësimdhënies. Megjithatë, në fushën e edukimit, shkollë apo universitet, mekanizmi i ndërmjetësimit nuk është zhdukur tërësisht. Nuk është e lehtë që një shkollë të funksionojë si një ndërmarrje, me të vetmet objektiva ekonominë dhe prodhimin, dhe të shndërrohen të gjithë mësimdhënësit në zyrtarë burokratë. Funksioni intelektual, pra edhe ai historik e antropologjik i transmetimit të dijeve mbi bazën e një sistemi vlerash dhe jo të një racionaliteti të mirfilltë ekonomik, duket se i reziston zhdukjes. Në botën e sotme ky mekanizëm vetëm se ka zvogluar rrezën e veprimit dhe është zhvendosur, duke u shfaqur në struktura më periferike por të domosdoshme, si në ato përgjegjëse për edukimin e të rinjve.

Mund të kuptohet kështu fati aktual i shkollës, i trishtë, e shkëputur, për natyrën e saj, e detyruar të qendrojë në periferi të sistemit prodhues. Pikërisht në shkolla po formohen intelektualë gjithnjë e më të ndikuar, fleksibël, të pazotë për të lidhur fenomenet e ndryshme mes tyre (historikë, filozofikë, letrarë, shkencorë) që t'i lexojnë në një perspektivë kulturore e shoqërore, pa i konvertuar dhe krijuar varësi nga fusha ekonomike e prodhuese.

Për të plotësuar panoramën e kushteve të mësuesit, mbetet për t'u sjellë në vëmendje një tjetër element. Kriza e identitetit të mësuesit të letërsisë varet edhe nga një tjetër faktor. Jetojmë në një shoqëri të dixhitalizuar që, sipas sociologur Carlo Bordoni, i shtyn brezat e rinj “të mos e njohin autoritetin aksiomatik të teksteve të shkruara”, që në këndvështrimin e tyre janë pa jetë, “të pamundur të sigurojnë ndërveprim në transmetimin e ideve, të mesazheve” (Said 1995)^{vii}. Libri pra, do të ishte “një objekt i vjetër, me të vërtetat e tij që nuk entuziazmojnë më njeri dhe pyetjet që nuk parashikojnë përgjigje”. Pra, shoqëria e dixhitalizuar është kthyer e tëra me fytyrë nga e ardhmja, duke mos ndjerë nevojën e kujtesës të së shkuarës. Bordoni madje shton se “një shoqëri ku proceset (mendore, kulturore, etike) ndryshojnë me shpejtësi marramendëse, nuk ka nevojë për përvojat e kaluara. Refuzon kujtesën historike” (Bordoni 2007)^{viii}.

Po a thua me të vërtetë libri, veçanarisht ai i klasikëve, nuk “parashikon përgjigje”, siç shkruan Bordoni? Nëse letërsia jep ndihmën e saj në formimin e ndjenjave, do të thotë se nuk privon individin nga diçka, përkundrazi ofron një larmi përgjigjesh. Shkrimet letrare sigurisht që nuk parashikojnë përgjigje konkrete, por të dhëna që pasurojnë dhe zhvillojnë procesin e shkrimit dhe të leximit.

Shkrimi i Bordoni, pa dyshim, zbulon vështirësitë që qendrojnë në horizont të mësimdhënies për mësuesin e letërsisë. Interneti, sado shpejt të përparojë, nuk do të mundet kurrë të zëvendësojë zërin dhe fytyrën e mësuesit, sepse dinamika konkrete e procesit të nxënies, akoma e regjistruar në ADN antropologjike të natyrës njerëzore, kërkon marrëdhënie komplekse psikologjike dhe kulturore, pra ndërpersonale; asnjë lloj dixhitalizimi nuk do të mund të përmbushë nevojën për kujtesën historike, traditën dhe vlerat, që ndjen çdo shoqëri për të ecur përpara. Pengesa kryesore e sociologjisë moderne shkaktohet nga miopia e saj; ajo e percepton tendencën dominuese të shtrirë në të tashmen dhe jo në dimensionin antropologjik. Sociologët dhe shoqëria dixhitale kanë të drejtë deri në diktimin e nevojës për forma ndryshe të mësimdhënies nga ato të natyrës kronologjike, retorike apo teknike formale, sepse tashmë nuk i përgjigjen realitetit, por nuk justifikohet heshtja ndaj dy problematikave themelore; nëse *mundemi* dhe si *duhet* të ndërtojmë një mënyrë të re të mësimdhënies së letërsisë.

Të mësosh t'i japësh kuptim tekstit është e rëndësishme sepse kemi mësuar t'i japim kuptim jetës. Pikërisht, ky është roli i mësuesit të shkencave humane në përgjithësi. Problemi qendron në faktin se sot kjo bëhet jo nga pozitat e historizmit, të identitetit kombëtar, të rrëfimit mitik të popullit komb. Atëherë, si mund të edukosh historinë pa historizma, etikën pa moral të paracaktuar, ndjenjën e qytetarisë pa konceptin popull apo komb?

Didaktika më e përparuar propozon konkretisht: kundërshtimin e një metode lineare dhe kronologjike; leximin e kryeveprave evropiane dhe botërore në vend të një renditje autorësh e rrymash letrare; vendosjen e këtyre kryeveprave në qendër të plejadave të shkrimtarëve dhe veprave të zgjedhura e të grupuara siaps temave dhe llojeve letrare; zgjerim i metodave të llojit ndërdisiplinor dhe ndërkulturor. Do të thotë që mësimi i letërsisë nuk duhet të jetë më i llojit teknik profesional, retorik, historik, filologjik, por tërësisht kulturor.

Si italianiste që jam, do të sjell një shembull nga letërsia italiane. Deri në krijimin e kombit italian, në vitin 1861, e gjithë letërsia me vlerë botërore, e shkruar në gjuhën volgare nga Dante, Petrarca, Boccaccio, më pas veprat epike kalorsiake të Ariosto-s dhe Tasso-s, narrativa dhe lirikat e Foscolo-s, Manzoni-t janë të papajtueshme me konceptin e letërsisë kombëtare, sepse kombi nuk ekzistonte, dhe si të tilla, duhej të liheshin jashtë. Ose, aktualisht, në garën e librave dhe shkrimtarëve në Itali për çmimin *Strega* 2018, merr pjesë edhe një shkrimtar 27 vjeçar shqiptar, Elvis Malaj, i cili shkruan në gjuhën italiane, dhe deri tani është përfshirë në dymbëdhjetëshen e kandidatëve finalistë. Mendoj se, pavarësisht gjuhës në të cilën shkruhet, shkrimtari shqiptar Elvis Malaj nuk duhet të jetë jashtë vëmendjes dhe interesave të të rinjve shqiptarë, ai duhet promovuar dhe rekomanduar nga mësuesit e letërsisë, sot kur të rinjtë lexojnë edhe nga gjuha origjinale, por kur edhe përkthimi ka marrë përmasa të zgjeruara si terreni ku letërsia tashmë ka bërë shtratin e vet. Kritiku i njohur shqiptar Aurel Plasari thekson se maksima e filologut të shquar Maks Aub, “Historia e letërsisë së çdo vendi zë fill nga autorët dygjuhësh”^{ix}, bëhet plotësisht e qartë po të studiohen fillimet e letërsisë shqipe, të letërsive të tjera të Ballkanit, të një pjese të madhe të Evropës Lindore e Perëndimore, përfshirë këtu edhe shkrimtarët e parë italianë që shkruanin në gjuhën frënge duke e përfillur më të lartë se italishten.

Mbetet për t'u përcaktuar kuptimi që merr historia, etika dhe morali qytetar mbi të cilat bazohet edhe identiteti i ri i mësuesit të letërsisë. Një ndihmesë mund të na vijë nga vetë letërsia, e sidomos nga ajo moderne, pasi ajo mbart vlera të dukshme dhe qenësore nga letërsia antike e mesjetare, gjë që e bën diskursin letrar gjithnjë të hapur, përmes bashkëpunimit me lexuesin që, sa herë e veshën tekstin me kuptim, aq herë ka ripërcaktuar edhe kuptimin e jetës. Veprat, sidomos ato moderne, kanë gjithmonë nevojë për t'u plotësuar.

Shkurtimisht, metoda e re e mësimdhënies së letërsisë ka të bëjë me diçka që duhet ndërtuar, dhe jo diçka që është ndërtuar. E tillë ka qenë situata edhe për identitetin kombëtar. Ky është edhe ndryshimi mes këngës *Italisë* (*All'Italia*) të Petrarca-s, kapitullit përmbyllës të *Princi* (*Principe*) të Mchiavelli-t, *Qivuret* (*Dei Sepolcri*) të Foscolo-s, që të gjitha vepra që shtrojnë terrenin për diçka që do të ndodhë, dhe Carducci-t, Pascoli-t dhe D'Annunzio-s që me poezitë e tyre janë bërë trumbetues të diçkaje që ekzistonte më parë, me qëllim rritjen e saj.

Pra, mësimdhënia e letërsisë sot duhet bazuar në kushtet e reja aktuale, në ndryshimet që ka pësuar letërsia në përmbajtje që nga rryma moderniste e në vazhdim, në përgjithësi në dhjetëvjeçarët e fundit. Përgjatë viteve Nëntëqind, imazhi i jetës që transmetojnë tekstet letrare është gjithnjë e më qartazi ai i jetës së vërtetë, pa trysnitë e rënda ideologjike. Ajo çfarë i intereson autorit dhe që e përfshin edhe lexuesin është raporti i drejtpërdrejtë, *uni* dhe bota, *uni* dhe shoqëria. Temat e gjera si dashuria, vdekja, rinia, pleqëria, paqja dhe lufta, trajtohen të zhveshura nga ideologjitë mbytëse, nga utopitë apo programimet në përgjithësi. Dalin në plan të parë momenti problematik, çastet e reflektimit, ndjenjat, bota e brendshme e individit.

Pasioni politik, impenjimi qytetar dhe moral ka fituar në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar një dimension të ri, enigmatik. Le të sjellim në kujtesë nga letërsia italiane konkluzionet në të cilat arrijnë shkrimtarë të impenjuar nga pikëpamja etike dhe politike si Primo Levi me veprat publicistike *Nëse ky është një njeri* (*Se questo è un uomo*) dhe *Armëpushimi* (*La tregua*), ose Pavese me romanin *Shtëpia në kodër* (*La casa in collina*), Fenoglio që e titullon kryeveprën e tij mbi luftën partizane *Një çështje private* (*Una questione privata*). Potenciali i fuqishëm aktual bën që visioni ideologjik teocentrik i Dantes në shkolla, duke qenë tepër i vjetëruar, të mbetet në sfond të veprës, ndërsa impenjimi politik dhe qytetar i autorit mund t'i tërheqë, pasi i shfaqet si reagim i individit, ose si shprehje e një ëndrre të madhe për bashkimin dhe shpëtimin e njerëzimit. Në vazhdim po propozojmë një fische didaktike me tematikë udhëtimin, së bashku me një seri tekstesh të këshilluara për tematikën në fjalë, argumentat rreth së cilëve mund të diskutohet, si edhe diskutimet ndërdisiplinore që mund të organizohen. Bëhet fjalë për formim studentësh universitarë. Shtrirja e tyre në orë mësimore mund të variojë në varësi të cilësisë së formimit kulturor dhe intelektual të tyre.

Udhëtimi në kohët moderne.

Tekste të këshilluara	Orët mësimore	Tematika dhe diskutime ndërdisiplinore
<ul style="list-style-type: none"> - Cristoforo Colombo; <i>Gazeta e bordit e udhëtimit të parë dhe zbulimi i Indive</i> - <i>Letra: Prolog Mbretërve të Spanjës.</i> - Ditari nga 7 shtatori (nisja nga ishujt Canarie) deri me 11 nëntor 1492 	4	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëtimi si zbulim i së panjohurës dhe ekspeditat pushtuese. - Imazhi i tjetrit ndryshe prej nesh. <p><i>Ditari i bordit</i> -Histori: zbulimi i Amerikës dhe udhëtimi rreth e qark. -Gjeografi -Filosofi: utopia dhe relativismi. Moro, Campanella, Montaigne.</p>
<ul style="list-style-type: none"> - Johann Wolfgang Goethe, <i>Udhëtim nëpër Itali.</i> - Ngaa Karlsbad në Brennero (3-8 shtator 1786). - Qëndrimi i parë në Romë (1-22 nëntor, 2-13 dhjetor, 17 shkurt 1787). - Napoli (17 mars), Sicili (3 -7 prill), Kujtimet e mia. - Qëndrimi i dytë në Romë (përshtypjet mujore). 	3	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Il gran tour</i>; udhëtimi formues. - Miti i Italisë - Il paesaggio - <i>Shkrimet autobiografike.</i> - Histori arti: Çdo të thotë “piktorese”.
<ul style="list-style-type: none"> - Ugo Foscolo: <i>Letrat e fundit të Jacopo Ortis</i>, pjesa II. - Novalis; <i>Heinrich von Ofterdingen</i> - Capit. I & II. - Alessandro Manzoni; <i>Të fejuarit.</i> • Lamtumirë male (fundi kap.VIII); • Udhëtimi i Renzit drejt Milanos (kap.XI); • Nga Milano në Adda (kap. XVI-XVII); • Kthimi i Renzit (kap.XXXVII); 	4 2	<ul style="list-style-type: none"> - Individit dhe shoqëria. Politika dhe romani. <i>Romani epistolar.</i> - Histori: Revolucioni francez dhe ndikimi i tij në Itali. - Udhëtimi simbolik i romantikëve. Në kërkim të vetvetes. - Filosofi: Schelling. - Udhëtimet si shkollë formuese për Rencin. Renci si hulamtues dhe narrator. Romani historik.

Një rrugëtim i tillë tematik mund të ndiqet edhe për dashurinë, vdekjen, figurën e gruas e kështu me radhë mund të bëhet e larmishme eksperiencia didaktike.

Në përmbyllje të këtij kontributi modest, mund të thuhet se sfidat e letërsisë moderne që lidhen me problematika të ekzistencës së saj, me kërkimin e vazhdueshëm të një drejtimi, me hapjen e spektrit, me dilemat dhe nevoja për zgjidhjen e tyre, përcaktojnë edhe perspektivat e zhvillimit të saj. Këta të fundit nuk rrëfejnë mbi një identitet tashmë të formuar, por hedhin dritë mbi një identitet të së ardhmes, në ndërtimin e të cilit përfshihet edhe lexuesi. Gjithashtu, kjo letërsi kërkon nga mësimdhënësit një qasje të re ndaj realitetit, që nuk është e prirur më nga mitet e së shkuarës, por që të konturojë një rrëfim të ri, jo vetëm kombëtar, por mundësiht planetar.

Nga ana tjetër mësimdhënësi është artizani i ri i plazmimit të ndërgjegjes, që vendos pranë njera tjetrës botë të ndryshme, në kohë dhe hapësirë, të së kaluarës dhe të tashmes, të kulturave të largëta me ato kombëtare, duhet pra të operojë pa kufij, duke përmbushur një vepër të pandërprerë “kontrabandë”, nga një kufi në tjetrin, që do të thotë të interpretojë, përkthejë, zhvendosë, nga fusha të dijes të largëta mes tyre dhe mes realiteteve historike e shoqërore deri më tani pa komunikim respektiv. Vetëm atëherë do të merrte kuptim edhe pozicionimi anësor i mësimdhënësit. Duke u bërë përfaqësues i të gjithë forcave që veprojnë në rrahët periferikë të fenomeneve mund të shndërrohet në një forcë, e njëherësh, arsye e një identiteti të ri.